



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-025**

**PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të krijimit të standardeve mjedisore në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian,

Miraton

**LIGJ PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

1. Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

## **Neni 2**

1. Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Ky ligj synon:

2.1. shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit , rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar;

2.2. përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;

2.3. ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtritshme dhe të papërtritshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;

2.4. bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;

2.5. bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;

2.6. nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.

2.7. të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;

2.8. të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe

2.9. të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

## **Neni 3**

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji është i detyrueshëm për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, personat juridik dhe fizik, vendas dhe të huaj që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Kosovës.

## **Neni 4**

### **Përkufizimet**

Termet e përdorura në këtë ligj, kanë këto kuptime:

**“Sistemi i integruar për mbrojtjen e mjedisit”** është sistem i mbrojtjes së mjedisit kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

**“Mjedisi”** është rrethina natyrore: ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgimia kulturore si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

**“Ndotja e mjedisit”** është ndikimi i drejtpërdrejtë ose e tërthortë e materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut.

**“Dëmtim i mjedisit”** është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore, të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore.

**“Degradim i mjedisit”** është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut.

**“Rrezik”** është potenciali i ndonjë aktiviteti, qoftë i drejtpërdrejt ose i tërthortë, që mund të shkaktojë dëm/ndotje për mjedisin, jetën, shëndetin e njeriut dhe të mirat materiale.

**“Aksident mjedisor”** është ndodhia e papritur dhe e pakontrolluar përkatësisht disa ndodhi të cilat krijohen me lirim, derdhjen ose hedhjen e materieve të rrezikshme, prodhimin, qarkullimin, përdorimin, transportimin, përpunimin, magazinimin apo ruajtjen afatgjate në mënyrë jo adekuate.

**“Pëlqim mjedisor”** është autorizim me shkrim i nxjerrë nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin, ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes së lejes për ndërtim.

**“Leja e integruar mjedisore”** është autorizimi me shkrim që lëshohet nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin që kërkohet për marrjen e lejes për operim.

**“Autorizim mjedisor”** është dokument zyrtarë i lëshuar me shkrim nga ministria, me të cilin i lejohet bartësit zhvillimi i aktivitetit apo zbatimi i projektit vetëm një here, në pajtim me kushtet e përcaktuara në të.

**“Leje mjedisore”** është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria me këtë ligj, e kërkuar me qëllim që të merret leja e punës.

**“Leje mjedisore komunale”** është dokument me shkrim që e lëshon komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit.

**“Vlerësimi i ndikimit në mjedis”** (VNM) është procesi i cili vlerëson përcaktimin e dëmeve të mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitetet tjera.

**“Vlerësimi strategjik mjedisor”** (VSM) është proces i vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis të një politike, plani ose programi.

**“Çrregullim mjedisor”** ka të bëjë me ndotjen e mjedisit kur materiet ndotëse i tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj.

**“Emision”** konsiderohet shkarkimi i materieve ndotëse, i energjisë dhe zhurmës nga burimet individuale dhe difuzive në mjedis.

**“Informacion mjedisor”** është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër në lidhje me gjendjen e përbërësve të mjedisit, masat, raportet, kostbenenfit analizat si dhe gjendja e shëndetit të njeriut.

**“Mbeturinë”** është çdo substancë ose lëndë të cilën zotëruesi e hedh, mendon ta hedh ose është i detyruar ta hedh.

**“Mbeturinë e rrezikshme”** janë mbeturinat toksike, gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përfllakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.

**“Materie të rrezikshme”** janë kimikatet dhe materiet tjera të cilat kanë karakteristika të dëmshme dhe të rrezikshme.

**“Ndotje”** është shkarkim i materieve dhe kimikateve në formë të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, si dhe vibrimet, rrezatimin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma të tjera të energjisë në mjedis, që kanë potencial domethënës që t’i shkaktojë dëme shëndetit të njeriut, organizmave të gjallë apo ekosistemeve dhe mjedisit në tërësi.

**“Ndotës”** është personi juridik apo fizik i cili me veprimin apo mosveprimin e tij shkakton ndotjen e mjedisit.

**“Ministria”** është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

**“Resurset natyrore”** janë të gjithë përbërësit e natyrës që njeriu i shfrytëzon për qëllime ekonomike. Resurset natyrore mund të jenë: të papërsëritshme (lëndët minerale) dhe të përsëritshme (të mirat biologjike, uji, toka e përsëritshme).

**“Vlerat e natyrës”** janë pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose interesit shkencor, estetik, kulturor, historik, arsimor dhe ekonomik.

**“Shfrytëzimi i qëndrueshëm”** nënkupton shfrytëzimin e resurseve natyrore që sigurojnë plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto resurse.

**“Zhvillimi i qëndrueshëm”** është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t'i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t'i përmbushin nevojat e veta.

**“Sanimi”** është proces i ndërmarrjes së masave për ndalimin e ndotjes dhe degradimin e mëtutjeshëm të mjedisit deri në nivelin i cili është i sigurt për shfrytëzim të mëtutjeshëm të lokacionit, duke përfshirë, rregullimin e hapësirës, revitalizimin dhe rikultivimin.

**“Riciklim”** është përpunimi i mbeturinave në procesin parësorë apo për dedikim tjetër, duke përfshirë riciklimin biologjik pa shfrytëzim të energjisë.

**“Fondi për mbrojtjen e mjedisit”** do të thotë instrument ekonomik për stimulimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit. në Kosovë.

**“Publiku”** konsiderohet një ose më shumë persona juridik ose fizik , shoqatat e tyre organizatat, apo grupimet.

**“Burimet e lëvizshme të ndotjes”** janë mjete me motor me djegie te brendshme që lëvizin dhe shkaktojnë ndotje në mjedis.

**“Statusi i mjedisit te rrezikuar”** është gjendje mjedisore kur tejkalohet shkalla e ndotjes e përcaktuar në bazë të matjeve, hulumtimeve dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes, në raport me normat e lejuara.

**“Instrumentet ekonomike”** janë instrumente, të cilat kanë për qëllim të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së subjekteve ekonomike, nëpërmes llogaritjes të shpenzimeve mjedisore për shfrytëzimin e resurseve natyrore.

**“Cilësia e mjedisit”** konsiderohet përqendrimi i materieve ndotëse në mjedis.

**“Kadastr i ndotësve”** është grup i të dhënave për burimet e ndotjes, llojin sasinë, mënyrën dhe vendin e shkarkimit, rrjedhjen apo vendosjen e materieve të dëmshme në mjedis, për stabilimentet dhe pajisjet për mbrojtjen e mjedisit si dhe proceset të cilat përdoren për mbrojtjen e mjedisit, të cilat të dhëna mblidhen për periudhën e vitit kalendarik.

## Neni 5

### Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit

#### 1. Qeveria

1.1. Qeveria, në bazë të propozimit nga ministri pas konsultimeve me ministrat tjerë të interesuar, do të miratojë aktet nënligjore për qëllim:

- 1.1.1. të arrihen objektivat dhe implementimi i plotë të këtij ligji;
- 1.1.2. të aplikohen parimet sipas nenin 6 të këtij ligji;
- 1.1.3. të bëhet përshtatja e kërkesave ligjore dhe procedurave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm me *acquis-in* mjedisor të Bashkimit Evropian.
- 1.1.4. të bëhen kufizimet, ndalimet dhe kontrollet tjera të emisioneve të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të liruara në mjedis nga ndotësit dhe mbeturinat nga instalime dhe projekte;
- 1.1.5. të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emisionet nga bazat e asfaltit, impiantet e gurëthyesve, nxjerrjeve të gurëve apo aktiviteteve tjera të nxjerrjes së gurëve, pikat e karburanteve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme;
- 1.1.6. të bëhen kufizimet dhe ndalimet për emitimet nga makineria dhe pajisjet, për shfrytëzimin apo vendosjen në treg dhe për kërkesat e etiketimit;
- 1.1.7. të bëhet trajtimi dhe përmbajtja e grumbujve të dheut-tokës së kontaminuar sipas standardeve teknike të trajtimit si dhe metodave të trajtimit dhe mbikëqyrjes;
- 1.1.8. të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emitimet nga bujqësia, ekonomia bujqësore e kafshëve, fermat e gëzofit, pylltaria dhe hurdhat e peshqve;
- 1.1.9. të bëhet përcaktimi i mënyrës së pagesave për lejet mjedisore;
- 1.1.10. të bëhet zvogëlimi i substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit;
- 1.1.11. të bëhet zvogëlimi i substancave dhe aktiviteteve që ndikojnë në ndryshimin klimatik;
- 1.1.12. të zbatohen kriteret dhe procedurat për shfrytëzim instrumenteve për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sipas nenit 7 të këtij ligji.

## 2. Ministri

- 2.1. do të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë dhe rajon;
- 2.2. do të miratojë akte nënligjore, udhëzime administrative, formularë, procedura të cilat janë në përgjegjësinë e tij sipas këtij ligji;

- 2.3. angazhohet për zbatimin e masave dhe standardeve mjedisore për të stimuluar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- 2.4. do të koordinojë përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe instrumenteve mjedisore me ministrinë tjera, komunat, entitetet private, organizatat shkencore dhe profesionale, organizatat jo qeveritare dhe me qytetarët;
- 2.5. do t'i propozojë qeverisë për miratim çmimoren për nxjerrjen e lejeve mjedisore, në bazë të nenit 31 të këtij ligji;
- 2.6. do të bëjë propozimin e anëtarëve të Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit në Qeveri, i cili do të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- 2.7. do të përcaktojë kriteret dhe procedurën për dhënien e mirënjohjeve,
- 2.8. do të sigurojë shfrytëzim të drejtë të fondeve të dhëna nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore sipas politikave të qeverisë me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu bënë përgatitjen e aplikimit të bashkë-financimeve të BE-së për projektet e investimeve në mjedis dhe implementimin e tyre;

### 3. Komunitat

- 3.1. bëjnë aplikim të plotë të parimeve të nenit 6;
- 3.2. bashkëpunojnë me Ministrinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre sipas këtij ligji,
- 3.3. zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre,
- 3.4. përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;
- 3.5. planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës.

### Neni 6

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, është zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm t'i plotësojnë nevojat e tyre.
2. Parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit. Autoritetet publike do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për zhvillimin dhe adoptimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

3. Parimet e harmonizimit gradual me standardet e Bashkimit Evropian. Mbrojtja e mjedisit do të bazohet në sjelljen graduale të standardeve të Bashkimit Evropian me qëllim krijimin e detyrueshëm të një mjedisi të shëndoshë për njeriun në parimet e ushtrimit të një praktike sa më adekuate, të adoptuar brenda komunitetit shkencor, për përmirësimin e mjedisit.
4. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit, deri në pikën e veprimit të arsyeshëm, duke konsideruar shpenzimet dhe përfitimet e pritura mjedisore, një aktivitet do të planifikohet dhe zbatohet në atë mënyrë që të parandalojë ose të ndërpresë efektet e dëmshme në mjedis pa rrezikimin e shëndetit të njeriut.
5. Parimi i parandalimit zbatohet përmes Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe zbatimin e Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes.
6. Mungesa e njohurive të tërësishme shkencore nuk mund të jetë arsye për mos ndërmarrjen e masave parandaluese të pengimit të rrezikimit dhe degradimit të mjedisit, në rastet e mundshme ose ekzistuese që kanë ndikim të mundshëm në mjedis.
7. Parimi “ndotësi paguan” ndotësi paguan kompensimin për ndotjen e mjedisit nëse gjatë aktivitetit të vet shkakton ngarkesë në mjedis me prodhimin, shfrytëzimin ose vënien në qarkullimit të lëndës së parë, gjysmë prodhimit ose prodhimit i cili përmban materie të dëmshme për mjedisin.
8. Parimi “shfrytëzuesi paguan“, shfrytëzuesi i resurseve natyrore detyrohet të paguajë një çmim real për shfrytëzimin e tyre dhe të rikultivojë hapësirën pas përfundimit të aktiviteve shfrytëzuese.
9. Parimi i përgjegjësisë subsidiare, Në rastet kur përgjegjësia për ndotje nuk mund të konstatohet atëherë përballimin e kostos së rehabilitimit dhe zvogëlimit të ndotjes në mjedis e bartin institucionet shtetërore.
10. Parimi i masave inkurajuese, Qeveria do të promovojë praktikën dhe aktivitetet që kanë për qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes me masa inkurajuese dhe stimuluese për personat juridik e fizik të cilët zgjedhin teknikat më të mira të mundshme dhe prodhimtari të pastër.
11. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë, çdo person juridik ose fizik dhe publiku, në rast të pësimit të dëmit material ose është para një rreziku të pësojë dëm material që ka të bëjë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ligjeve të veçanta ose akteve nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit, ka të drejtë të ngre padi ose të kërkojë nga gjykata kompetente ose autoriteti publik të mbroj të drejtat e veta.
12. Parimi i qasjes së publikut në informata. Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.
13. Parimi i nivelit të lartë të mbrojtjes.
14. Parimi i përputhshmërisë me ligjin e Bashkimit Evropian.



15. Parimi i masave paraprake.
16. Parimi që nënkupton se dëmi mjedisor duhet të rregullohet në burim.
17. Parimi i mbulimit të shpenzimeve.

**Neni 7**  
**Instrumentet për mbrojtjen e mjedisit.**

1. Mbrojtja e mjedisit rregullohet me:

- 1.1. infrastrukturë ligjore;
- 1.2. dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.3. instrumentet ekonomike;
- 1.4. dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- 1.5. instrumentet për monitorimin e mjedisit;
- 1.6. menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.

**KREU II**  
**SHFRYTËZIMI DHE MBROJTJA E RESURSEVE NATYRORE**

**Neni 8**  
**Shfrytëzimi i resurseve natyrore**

1. Shfrytëzimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore bëhet përmes planifikimit për ruajtjen e cilësisë dhe llojlojshmërisë së tyre, në përputhje me kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta.
2. Resurset natyrore mund të hapen në shfrytëzim në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera të veçanta.

**Neni 9**  
**Mbrojtja e resurseve natyrore**

1. Mbrojtjen e resurseve natyrore e sigurojnë institucionet e Kosovës në përputhje me ligjet e kësaj fushe si dhe përmes:

- 1.1. zbatimit të Strategjisë, planeve dhe programeve mjedisore;
  - 1.2. zbatimit të standardeve, dispozitave dhe rregulloreve për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve natyrore;
  - 1.3. Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM);
  - 1.4. Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM);
  - 1.5. Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes (PKIN);
  - 1.6. mbajtjes së kadastrave për shfrytëzimin e resurseve natyrore;
  - 1.7. monitorimit të shfrytëzimit të resurseve natyrore;
  - 1.8. zvogëlimit të çrregullimeve mjedisore;
  - 1.9. rehabilitimit dhe rikthimit të mjedisit në gjendjen e mëparshme në përputhje me projektin.
2. Të drejtat në koncesione dhe procedura për përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, përcaktohen me ligj të veçantë.

### **Neni 10** **Pëlqimi për shfrytëzim**

1. Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.
2. Pëlqimin nga paragrafi 1. të këtij neni e jep Ministria.

### **Neni 11** **Detyrimet e shfrytëzuesit**

1. Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të cilat duhet të parandaloj ndotjen e mjedisit.
2. Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera.
3. Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që rregullisht të informojë Ministrinë rreth aktiviteteve të kryera. Raportet e tilla janë të hapura për publikun.

## **Neni 12**

### **Vlerat e mbrojtura të natyrës**

1. Vlerat e mbrojtura të natyrës përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.
2. Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojlojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

## **Neni 13**

### **Shfrytëzimi i hapësirës**

1. Me planet hapësinore dhe urbane përcaktohen zonat e ndërtimit në lokacionet e caktuara, varësisht nga kapaciteti i pranueshëm i ndotjes së mjedisit dhe qëllimeve të ndërtimit brenda vendeve të caktuara në kuadër të këtyre lokacioneve.
2. Në zonat e mbrojtura lejohet kryerja e aktiviteteve në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e veçanta, në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit.

## **Neni 14**

### **Sipërfaqet publike të gjelbëruara**

1. Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në planet hapësinore dhe urbane, ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.
2. Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.

## **Neni 15**

### **Mbrojtja e përbërësve të mjedisit**

Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, ajrit, pyjeve dhe llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore, bëhet veç e veç dhe të lidhura ngushtë mes veti në ndërveprimin dhe integritetin e tyre, ndërsa rregullohen me ligje të veçanta.

## **Neni 16**

### **Materiet e rrezikshme**

1. Administrimi me materie të rrezikshme si dhe planifikimi, organizimi dhe ndërmarrja e masave për parandalimin dhe sanimin, kryhet në kushte dhe në mënyrën më të cilën sigurohet zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe përgjegjësitë adekuate në fatkeqësi, në përputhje me ligj.
2. Personi juridik ose fizik i cili administron me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë për të minimizuar rrezikun për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
3. Personi juridik dhe fizik i cili administron me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që rregullisht të informojë Ministrinë rreth aktiviteteve të kryera. Raportet e tilla janë

## **Neni 17**

### **Administrimi me mbeturina**

Administrimi me mbeturina bëhet sipas kushteve dhe masave të përcaktuara me ligj te veçantë.

## **Neni 18**

### **Mbrojtja nga zhurma dhe vibracioni**

Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

## **Neni 19**

### **Mbrojtja nga rrezatimi**

Mbrojtja nga rrezatimi bëhet përmes aplikimit të sistemit të masave me të cilat parandalohet rrezikimi i mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimi i rrezatim-eve të cilat rrjedhin nga burimet e rrezatimit jonizues dhe jo jonizues dhe mënjanimi të pasojave të emisionit të cilat emitohen nga burimet e rrezatimit ose mund të emitohen, në përputhje me ligj të veçantë.

## **KREU III**

### **DOKUMENTET PËR MBROJTJËN E MJEDISIT**

#### **Neni 20**

#### **Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit**

1. Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm (në tekstin e mëtutjeshëm: Strategjia) me propozim të Qeverisë e miraton Kuvendi i Kosovës.
2. Strategjia përfshinë objektivat dhe qëllimet për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare. me mundësi të rishikimit çdo dy (2) vjet.
3. Strategjia përmban:
  - 3.1. përshkrimin e gjendjes mjedisore;
  - 3.2. politikat për përdorimin e resurseve natyrore;
  - 3.3. prioritetet strategjike për përdorimin e resurseve natyrore, përfshirë kohën dhe lokacionin hapësinor, sasinë dhe cilësinë;
  - 3.4. shfrytëzimin racional të resurseve natyrore të papërritshme dhe zëvendësimi i tyre me ato të ri-përtërishme;
  - 3.5. propozimin e kushteve elementare për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e tij;
  - 3.6. masat afatgjata dhe afatshkurtra për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit;
  - 3.7. kushtet për zbatimin e masave më të favorshme prodhuese, teknike-teknologjike, ekonomike dhe masave të tjera për zhvillim të qëndrueshëm dhe menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit.
4. Strategjinë e harton Ministria në bashkëpunim me ministrinë tjera, institucionet shkencore të Kosovës, me publikun dhe palët e interesuara.
5. Strategjia, para se të dërgohet në Qeveri, jepet në diskutim publik të paktën dyzetepesë ditë me qëllim që publiku të shpreh mendimet, sugjerimet dhe komentet, të cilat do të merren parasysh me rastin e hartimit të draftit final të Strategjisë.
6. Ministria i raporton Qeverisë dhe Kuvendit një (1) herë në vit për realizimin e Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit.

## **Neni 21**

### **Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis**

1. Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis me propozim të Ministrisë e nxjerr Qeveria për periudhën pesë (5) vjeçare dhe e aprovon Kuvendi.
2. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis , nxirret në afat prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh pas miratimit të Strategjisë
3. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis përmban: gjendjen, masat, vlerësimin e ndikimit në shëndetin e popullatës në rast të rrezikimi të mjedisit, bartësit, mënyrën, dinamikën dhe mjetet për realizimin e tyre.

## **Neni 22**

1. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis nxirret për:
  - 1.1. mbrojtjen e tokës;
  - 1.2. mbrojtjen e ujit;
  - 1.3. mbrojtjen e ajrit dhe ndryshimet klimatike;
  - 1.4. mbrojtjen e pyjeve;
  - 1.5. mbrojtjen e ekosistemeve, llojlojshmërinë biologjike dhe peizazhore dhe mbrojtjen e natyrës;
  - 1.6. administrimi me mbeturina;
  - 1.7. administrim me kimikate;
  - 1.8. mbrojtjen nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues;
  - 1.9. mbrojtjen nga aksidentet mjedisore;
  - 1.10. mbrojtjen nga zhurma;
  - 1.11. shfrytëzimi i racional i energjisë;
  - 1.12. zhvillimin e sistemit informativ;
  - 1.13. zhvillimin dhe aplikimin e instrumenteve ekonomike etj.

2. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis përmban: gjendjen, masat, vlerësimin e ndikimit në mjedis, shëndetin e njeriut, bartësit, mënyrën, afatet kohore dhe mjetet financiare për realizimin e tij.

### **Neni 23** **Plani i sanimit**

1. Plani i sanimit nxirret kur shkalla e ndotjes në një lokacion të caktuar tejkalon efektet e masave të ndërmarra, gjegjësisht rrezikohet kapaciteti i mjedisit ose kur ekziston rreziku nga dëmtimi i përhershëm i cilësisë ose dëmtimit të mjedisit.

2. Planin e sanimit me propozim të Ministrisë, e nxjerr Qeveria kur:

2.1. është e nevojshme të ndërmerren masa të shpejta dhe intervenimet në rastet e jashtëzakonshme;

2.2. ndotja e mjedisit e rrezikon zonën me rëndësi të veçantë për Kosovën ose shkakton pasoja të dëmshme;

2.3. subjekti përgjegjës është jashtë juridiksionit të Kosovës;

2.4. subjekti përgjegjës është i panjohur.

3. Në rast të tejkalimit të normave të lejuara të emisionit, cilësi të mjedisit dhe aktiviteteve tjera të dëmtimit të mjedisit, ndotësi është i detyruar që me shpenzimet e veta të bëjë dhe realizoj planin sanues.

### **Neni 24** **Planet e Veprimit Lokal ne Mjedis dhe Programet Mjedisore**

1. Komunat miratojnë planet e veprimit lokal ne mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj .

2. Në hartimin e planeve të veprimit lokal dhe programeve mjedisore, marrin pjesë. publiku, OJQ-të, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit.

3. Komunat i raportojnë Ministrisë për zbatimin e planit të veprimit lokal dhe programit mjedisor.

4. Dy ose më shumë komuna mundë të hartojnë dhe miratojnë së bashku plane ose programe të përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit për zvogëlimin e efekteve negative në mjedis.

**Neni 25**  
**Raporti për gjendjen e mjedisit**

1. Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë, i paraqet Kuvendit raport një (1) vjeçar për gjendjen e mjedisit.
2. Raporti përfshinë të dhëna mbi:
  - 2.1. gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm;
  - 2.2. ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës;
  - 2.3. gjendjen e mjedisit të rrezikuar;
  - 2.4. zbatimin e Strategjisë, Planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis;
  - 2.5. masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
  - 2.6. mënyrën e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit;
  - 2.7. analizat për funksionimin e institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve të tjerë për mbrojtjen e mjedisit;
  - 2.8. financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.
3. Raporti publikohet dhe duhet të jetë i hapur për publikun.

**KREU IV**  
**MASAT DHE KUSHTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

**Neni 26**  
**Planifikimi dhe ndërtimi**

1. Rregullimi i hapësirës, shfrytëzimi i resurseve natyrore të përcaktuara me plane hapësinore dhe plane të tjera mbështetet në detyrim të:
  - 1.1. respektimit të kapacitetit të ndotjes së mjedisit;
  - 1.2. ruajtjes dhe avansimit të resurseve natyrore, që sa më shumë ato të ripërtërihen dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale;



1.3. sigurimit të mbrojtjes dhe funksionimit të papenguar të vlerave natyrore të mbrojtura së bashku me rrethinën e tyre, dhe të ruajtjes në masë të madhe të vendndodhjeve dhe vendbanimeve natyrore të llojeve të egra bimore dhe shtazore dhe të bashkësive të tyre;

1.4. sigurimit të mbrojtjes së hapësirës së ndërtuar;

1.5. sigurimit të kushteve për pushim dhe rekreacion të njeriut;

1.6. përcaktimit të masave për mbrojtjen e mjedisit;

1.7. prezantimit të gjendjes ekzistuese sipas elementeve nga nën-paragrafët 1.1. deri 1.5. paragrafi 1. i këtij neni dhe gjendjes së planifikuar së bashku me masat e nevojshme për realizimin e këtyre planeve.

2. Ministria, respektivisht komunat marrin pjesë në procesin e përgatitjes dhe miratimit të planeve nga paragrafi 1. i këtij neni, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

## **Neni 27** **Planifikimi hapësinor**

1. Me planet hapësinore dhe planet tjera, sigurohen masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit e veçmas përcaktohen:

1.1. kriteret e veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës, burimeve të furnizimit me ujë, burimeve të ujërave termale dhe minerale, pyjeve, tokës bujqësore, sipërfaqeve të gjelbëruara publike, zonave rekreative etj;

1.2. zonat e rrezikuara të mjedisit, zonat e ndotura, zonat e rrezikuara nga erozioni dhe përmytjet, zonat për eksploatimin e resurseve natyrore etj. dhe masat për sanimin e këtyre zonave;

1.3. masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit, sipas të cilave duhet të përdoret hapësira e përcaktuar për eksploatimin e resurseve natyrore, respektivisht, ku do të ndërtohen objektet industriale dhe energjetike, objektet për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave, objektet të infrastrukturës dhe objektet tjera, me ndërtimin ose shfrytëzimin e të cilave mund të rrezikohet mjedisi.

2. Kushtet për sigurimin e masave të cekura në paragrafin 1. të këtij neni i përcakton Ministria, respektivisht komuna, me kërkesë të institucionit kompetent për hartimin dhe miratimin e planit, dhe në bazë të mendimit të organizatave profesionale kompetente.

## **Neni 28**

### **Vlerësimi strategjik mjedisor**

1. Qeveria dhe komunat e Kosovës duhet të arrijnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të harmonizojnë çështjet mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve, duke siguruar se vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për planet dhe programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis.
2. Vlerësimi strategjik mjedisor duhet të jetë në përputhje me vlerësimet tjera të ndikimit në mjedis, si dhe me planet dhe programet për mbrojtjen e mjedisit dhe kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të veçantë.

## **Neni 29**

### **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**

1. Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis bëhet për projekte të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe ndryshimet e teknologjisë, rekonstruimin, zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut.
2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, përfshinë projektet nga lëmenj të industrisë, xehetarisë, energjetikës , komunikacionit, turizmit, bujqësisë , pylltarisë , ujërave dhe veprimtarive komunale, si dhe të gjitha projektet të cilat planifikohen në zonat e mbrojtura të natyrës dhe në rrethinën e mbrojtur të vlerës së paluajtshme të kulturës.
3. Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik pa të cilin nuk mund të fillon zbatimi i projektit dhe kryhet në përputhje me procedurën sipas ligjit të veçantë.

## **Neni 30**

### **Parandalimi i Integruar dhe Kontrolli i Ndotjes**

1. Për punën e impianteve të reja të cilat mund të kenë ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin e njeriut duhet të sigurohet leja e integruar mjedisore me të cilën sigurohet parandalimi dhe kontrolli i ndotjes së mjedisit.
2. Llojet e aktiviteteve dhe impianteve, kushtet dhe procedura e dhënies së lejes së integruar, mbikëqyrja dhe çështjet tjera të rëndësishme për parandalimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes të mjedisit, rregullohet me ligj të veçantë.

### **Neni 31**

#### **Leja Mjedisore**

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.
2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.
3. Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara.

### **Neni 32**

#### **Leje Mjedisore Komunale**

1. Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshira në nenet 29, 30, 31 dhe 33 të këtij ligji, të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis, lëshohet Leje Mjedisore Komunale që është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik.
2. Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore. Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.
3. Lejen Mjedisore Komunale e lëshon komuna.

### **Neni 33**

#### **Autorizimi mjedisor**

1. Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshirë në nenet 29, 30 dhe 31 të këtij ligji, askush nuk ka të drejtë të kryejë apo ndërmarrë ndonjë veprimtari që mund të shkaktojë çrregullim në mjedis nëse për këtë veprimtari nuk është marrë autorizim mjedisor nga Ministria.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton listën e veprimtarive që kërkojnë autorizim mjedisor, formën e aplikimit, procedurën e aplikimit dhe përmbajtjen e autorizimit mjedisor.

## **Neni 34**

### **Masat e rehabilitimit**

1. Kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar dëm mjedisor me qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me çrregullime mjedisore, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar.
2. Në rast se personi juridik ose fizik, apo autoriteti publik merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjell dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor, ai ka obligim që në afat të caktuar të ndërmarr masa dhe me aktivi-tetin e tij në të ardhmen:
  - 2.1. të zvogëloj emisionin dhe cilësinë e mjedisit në nivelin e lejuar;
  - 2.2. të minimizoj rrezikun për një aksident mjedisor në pajtim me ligjin.
3. Personi juridik ose fizik apo autoriteti publik nga i cili kërkohet të ndërmarrë masa nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni, është i detyruar ti paraqes Ministrisë planin për masat që duhet ti ndërmerr.
4. Ministria në afat prej tridhjetë ditë duhet t'i përgjigjet palës.
5. Në rast se Ministria vlerëson që masat e parapara nga paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nuk janë adekuate, Ministria në afat prej tridhjetë ditëve i kërkon personit juridik ose fizik apo autoritetit publik, modifikimin e planit.
6. Në rast se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik, konstaton që modifikimet e kërkuara nga Ministria janë të panevojshme dhe tepër të shtrenjta dhe nuk janë në përputhje me paragrafin 1. ose 2. të këtij neni, ka të drejtë ankese.
7. Nëse identiteti i palës përgjegjëse për dëmin mjedisor nuk dihet ose në rastet kur personi juridik ose fizik nuk ka mjete financiare të mjaftueshme të sanoj dëmin mjedisor, Qeveria do të jetë përgjegjëse, kur dëmi paraqet rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe ajo duhet t'a aprovojë dhe zbatoj një program të arsyeshëm për sanimin e dëmit.
8. Në rastet kur, identiteti i palës zbulohet, Qeverisë do ti paguhen mjetet e shpenzuara për rehabilitimin e dëmit.
9. Në rastet kur programi i sanimit përfshinë edhe përgjegjësitë e ministrive tjera kjo ju jep atyre të drejtë që të japin pëlqimet apo propozimet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve.
10. Për planin e paraqitur në Ministri, publikut i mundësohet qasje për komente në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, me që rast komentet duhet të merren në konsideratë.
11. Plani i miratuar është i hapur për publikun.

## **MASAT E VEÇANTA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

### **Neni 35**

#### **Planet e intervenimit në rast të aksidentit në mjedisor**

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.
2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë; llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.
3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mundë të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.
4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.
5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri i përcakton me akt nënligjor.

## **KUSHTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

### **Neni 36**

#### **Normat e emisionit dhe cilësisë të mjedisit**

Qeveria me akt nënligjor i përcakton normat e emisionit dhe cilësisë të mjedisit respektivisht vlerat kufitare të emisionit dhe cilësisë të mjedisit të materieve ndotëse dhe energjisë duke përfshirë edhe emisionin nga burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme në ajër, ujë dhe tokë.

### **Neni 37**

#### **Kufizimet për aplikimin e normave**

1. Me qëllim të aplikimit gradual të normave të emisionit dhe cilësisë të mjedisit nga neni 35 të këtij ligji dhe ruajtjes së vlerave të kulturës dhe të natyrës, Qeveria mundet, për kohë të caktuar të kufizojë punën e impianteve ekzistuese dhe kryerjen e aktiviteteve në zonën e caktuar.
2. Afatin për kufizimet e normave nga paragrafi 1 i këtij neni Qeveria e përcakton në përputhje me normat përkufizuese dhe programin e përafrimit gradual me standardet e BE-së.

3. Qeveria mundet për një kohë të suspendojë, pjesërisht apo plotësisht, aplikimin e normave të caktuara për disa ndotës ekzistues veprimtaria e të cilëve është në interes të përgjithshëm.

4. Afati për të cilin Qeveria suspendon aplikimin e normave nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohet me marrëveshje.

### **Neni 38** **Paralajmërimi i publikut**

1. Ministria e njofton publikun për marrjen e masave të veçanta në raste të rrezikut të drejtpërdrejtë ose në raste të tejkalimit të nivelit të vlerave të përcaktuara të ndotjes së mjedisit.

2. Ministri me akt nënligjor përcakton kriteret për marrjen e masave nga paragrafi 1 të këtij neni.

3. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë nxjerrë aktin për vendosjen e masave të posaçme sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse ndotja është e përkufizuar në territorin e vet.

### **Neni 39** **Detyrimi për njoftim dhe bashkëpunim**

1. Çdo person që është i njoftuar për dëmtim të mjedisit ose për aksident mjedisor, duhet të njoftojë Inspektoratin për mbrojtjen e mjedisit ose organin tjetër përgjegjës.

2. Policia dhe zyrtarët publik të autorizuar, të cilët, gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare marrin informatë për aksident mjedisor ose çrregullim tjetër mjedisor, duhet të njoftojnë menjëherë Inspektoratin për mbrojtjen e mjedisit ose organin tjetër përgjegjës.

### **Neni 40** **Njoftimi i shteteve ndërkufitare fqinje**

1. Nëse një projekt mund të ndikojë drejtpërdrejt në mjedis përtej territorit të Kosovës, Ministria, pas konsultimit me Qeverinë, informon shtetet përkatëse dhe u ofron atyre dokumentacionin përkatës, në pajtim me konventat ndërkombëtare.

2. Shtetet ndërkufitare të cilat mund të preken nga projekti, mund të japin mendimet dhe komentet e tyre përfshirë edhe dëgjimin publik. Mendimet duhet të merren në konsideratë me rastin e miratimit të projektit.

3. Në rast aksidenti mjedisor i cili mund të ndikojë drejtpërdrejt në mjedis përtej territorit të Kosovës, Ministria, pas konsultimit me Qeverinë informon shtetet që ndikohen nga aksidenti mjedisor.

**Neni 41**  
**Statusi i Mjedisit të Rrezikuar**

1. Statusin e mjedisit të rrezikuar, regjimin e sanimit dhe përmirësimit të zonës me rëndësi të veçantë për Kosovën e përcakton Qeveria, pas marrjes së mendimit të institucioneve gjegjëse, ndërsa statusin e mjedisit të rrezikuar për komunën e përcakton komuna pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria.
2. Qeveria me akt nënligjor përcakton kriteret për shpalljen e statusit të mjedisit të rrezikuar si dhe prioritetet për sanimin dhe përmirësimin e tij.

**Neni 42**  
**Sistemet e certifikuara për menaxhimin e mjedisit**

1. Kosova nxitë dhe përkrah personat juridik dhe fizik që zbatojnë sistemet e certifikuara të menaxhimit të mjedisit ISO 9000, ISO 14001 dhe EMAS.
2. Personave juridik dhe fizik, që zbatojnë sisteme të certifikuara për menaxhimin e mjedisit, u krijohen lehtësi procedurale në procesin e VNM dhe në marrjen e lejes mjedisore.

**Neni 43**  
**Paralajmërimi në deklaratë**  
**Shenja mjedisore**

1. Prodhimet për konsum të gjërë mund të shpërblehen me etiketën mjedisore, nëse prodhimi, distribuimi, konsumimi dhe depozitimi final i prodhimit kanë ndikimin më të ulët në mjedis të prodhimit e njëjta të cilat i përgjigjen rregullave që janë në fuqi.
2. Kushtet dhe procedurat për përvetësim dhe shfrytëzim të etiketës do të përcaktohet me akt të veçantë, nga Ministria.

**Neni 44**  
**Mirënjohjet dhe shpërblimet**

1. Mirënjohjet dhe shpërblimet për arritjet në fushën e mbrojtjes së mjedisit jepen për:
  - 1.1. parandalimin e ndotjes së mjedisit;
  - 1.2. zgjidhjet më të mira në procesin e prodhimit në raport me mjedisin dhe shfrytëzimin e energjisë - teknologjia e pastër;
  - 1.3. projektet zhvillimore dhe hulumtuese në mbrojtjen e mjedisit;

- 1.4. kontributin në zhvillimin e programeve të edukimit në mbrojtjen e mjedisit;
  - 1.5. kontributin e individëve për përparim në mbrojtjen e mjedisit ose për kontributin në bashkëpunimin ndërkombëtar në mbrojtjen e mjedisit;
  - 1.6. kontributin e shoqatave profesionale, OJQ- ve dhe të tjerëve në zhvillimin dhe përparimin e mbrojtjes së mjedisit.
2. Procedurën, mënyrën dhe kushtet për dhënien e mirënjohjeve dhe shpërblimeve, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

## **MASAT PËR MBROJTJEN NGA MATERIT E RREZIKSHME**

### **Neni 45**

#### **Prodhimi dhe vënia në qarkullim i substancave të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit**

1. Prodhimin, importin, eksportin, kalimin transit dhe lëshimit në treg të substancave të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit, Ministri e rregullon me akt nënligjor.
2. Ndalohet importi dhe eksporti i substancave të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit, respektivisht prodhimet të cilat përmbajnë këto substanca, qe janë konfirmuar si të tilla me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga shtetet, respektivisht në shtetet të cilat nuk janë nënshkruese të këtyre marrëveshjeve

### **Neni 46**

#### **Importi, eksporti dhe kalimi transit i kimikateve të rrezikshme, mallrave të kontrolluara, materieve radioaktive dhe të rrezikshme dhe mbeturinave të rrezikshme**

Importi, eksporti dhe kalimi transit i kimikateve të rrezikshme, mallrave të kontrolluara, materieve radioaktive dhe të rrezikshme dhe mbeturinave të rrezikshme rregullohen me akte të veçanta ligjore.

### **Neni 47**

#### **Detyrimet e personit gjatë veprimit me kimikate të rrezikshme**

1. Veprimi me kimikatet të rrezikshme në prodhim, përdorim, transport, qarkullim, përpunim, magazinim dhe deponim bëhet në mënyrë që mos të vihet në rrezik jeta dhe shëndeti i njeriut, të mos ndotet mjedisi, si dhe të sigurohen dhe të ndërmerren masa mbrojtëse nga aksidentet si dhe masat tjera të parapara me ligj.



2. Personi juridik ose fizik i cili prodhon, transporton, lëshon në qarkullim, shfrytëzon, përpunon, magazinon dhe deponon materiet e rrezikshme, është i detyruar që të:

2.1. hartojë planin e mbrojtjes nga aksidenti, që së paku çdo dy (2) vjet bënë azhurimin ose rishikimin e tyre në përputhje më ndryshimet në punën e stabilimenteve, aplikimin e teknologjisë apo kryerjen e aktiviteteve përfshirë edhe verifikimin e gatishmërisë për aplikimin e tyre;

2.2. aplikojë masat parandaluese dhe masat tjera të it të rrezikut nga aksidenti sipas planit të mbrojtjes në rast aksidenti;

2.3. hartoj raportin për gjendjen e sigurisë i cili do të jetë në dispozicion të publikut dhe që së paku çdo pesë vjet, si dhe në rastin e ndryshimeve në punën e stabilimenteve ose kryerjes së aktiviteteve, bënë shqyrtimin e raportit për gjendjen e sigurisë.

3. Personat juridik ose fizik nga paragrafi 2. i këtij neni duhet të mbajnë evidencën për llojet dhe sasinë e kimikateve të rrezikshme.

4. Në rast të prishjeve të pajisjeve ose instalimeve për mbrojtjen e mjedisit, gjë që shkakton tejkalimin e vlerave të lejuara të emisionit të ndotjes, personat nga paragrafi 2. i këtij neni janë të detyruar që menjëherë të informojnë për këtë Ministrinë, komunën dhe publikun.

#### **Neni 48**

#### **Shpallja e gjendjes së rrezikshmërisë**

1. Në rast të aksidentit mjedisor, varësisht nga përmasat, brenda ose jashtë pajisjeve dhe vlerësimit të pasojave të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt ose të tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, Ministria ose komuna e shpallë gjendjen e mjedisit të rrezikuar dhe për këtë e njofton publikun për masat e ndërmarra

2. Për aksidentet mjedisore, të cilat kanë ndikim jashtë kufijve të Kosovës, shpalljen e gjendjes së rrezikuar të mjedisit dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren e bënë Qeveria.

#### **Neni 49**

#### **Ndërmarrja e masave të sanimit dhe përgjegjësia subsidiare**

1. Për parandalimin e përhapjes së mëtutjeshme të ndotjes të shkaktuar nga aksidenti mjedisor, personi juridik ose fizik menjëherë ndërmerr masa të sanimit sipas planeve për mbrojtjen me shpenzime të veta.

2. Në rastet kur përgjegjësia për ndotjen e shkaktuar nga aksidenti mjedisor nuk mundë të vërtetohet, atëherë përgjegjësinë për sanim e merr institucioni qendror ose lokal dhe ndërmerr masat e sanimit, gjegjësisht rehabilitimit sipas planeve të mbrojtjes me shpenzime e veta.

3. Nëse vërtetohet ndotësi i cili është përgjegjës për aksidentin mjedisor, institucioni i cili i ka bartë shpenzimet për mënjanimin e pasojave të ndotjes së mjedisit ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve, nga ndotësi i identifikuar.

## **KREU V**

### **MONITORIMI DHE INFORMIMI PËR MJEDISIN**

#### **Neni 50**

##### **Monitorimi i mjedisit**

1. Ministria në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligj siguron kontrollin e vazhdueshëm dhe bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.
2. Personat juridik ose fizik të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre e ndotin mjedisin, në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.
3. Komunitet, në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.
4. Monitorimi i mjedisit kryhet përmes matjeve sistematike, hulumtimit dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes dhe ndotjes së mjedisit të cilat përfshijnë përcjelljen e faktorëve natyror, respektivisht ndryshimit të gjendjes dhe karakteristikave të mjedisit, përfshirë edhe monitorimin tej kufitarë, të ajrit, ujit tokës, pyjeve, llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore florën dhe faunën, elementeve klimatologjike, mbështjellësit të ozonit, rrezatimit jonizues dhe jojonizues, zhurmës, mbeturinave, paralajmërimit të hershëm të aksidenteve në mjedis të bashku me përcjelljen dhe vlerësimin e nivelit të ndotjes së mjedisit, si dhe detyrimeve dhe përgjegjësi të marra nga marrëveshjet ndërkombëtare.
5. Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit, përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të Mbrojtjes së Mjedisit.
6. Me propozim të Ministrisë, Qeveria, me akt nënligjor përcakton kriteret për identifikimin e numrit dhe shtrirjes së pikave matëse, rrjetin e pikave matëse, vëllimin dhe shpeshësinë e matjeve, klasifikimin e dukurive të cilat përcillen, metodologjinë e punës dhe indikatorët e ndotjes së mjedisit dhe monitorimin e tyre, afatet dhe mënyrën e dorëzimit të dhënave.

7. Monitorimin e mjedisit në Kosovë sipas paragrafit 1 të këtij neni e bënë Ministria, personat juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre mund të ndotin mjedisin si dhe personat e autorizuar nga ndotësi ose Ministria.

8. Çdo palë e interesuar ka të drejtë në çdo kohë të ketë qasje në regjistrat ose evidencat e Ministrisë që përmbajnë informata dhe të dhëna për gjendjen e mjedisit në përputhje me ligj.

9. Personat juridik ose fizik të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre mund të ndotin mjedisin, duhet të sigurojnë mjetet financiare për monitorimin e mjedisit.

### **Neni 51**

#### **Monitorimi i emisionit, cilësisë të mjedisit dhe regjistrimi i të dhënave**

1. Çdo person juridik ose fizik i përfshirë në aktivitete të vazhdueshme që paraqesin burim të ndotjes, është i detyruar që në pajtim me ligj të sigurojë:

1.1. monitorimin e emisionit dhe cilësisë së mjedisit;

1.2. bartjen e shpenzimeve të matjes së emisionit dhe parametrave të cilësisë së mjedisit, në zonën e ndikuar;

1.3. mbajtjen e shënimeve për ndotjen e mjedisit, që duhet të përmbajnë të dhëna për energjinë dhe materiet e përdorura;

1.4. përcjelljen e efekteve të aktiviteteve që ndikojnë në mjedis, mirëmbajtjen, llojet dhe nivelin e ndotjes, substancave të rrezikshme apo mbeturinave të rrezikshme.

2. Të dhënat nga paragrafi 1. të këtij neni, subjektet përgjegjëse, janë të detyruar të ia dërgojnë Ministrisë.

3. Qeveria, me akte ligjore, përcakton llojin e emisionit, parametrat për cilësinë e mjedisit dhe të dukurive tjera të cilat janë subjekt i monitorimit të ndotjes, metodologjinë e matjeve, marrjen e mostrave, mënyrën e evidentimit, afatet e dorëzimit dhe ruajtjes së të dhënave.

### **Neni 52**

#### **Sistemi i Informimit Mjedisor**

1. Me qëllim të identifikimit, klasifikimit, për-punimit, përcjelljes dhe evidentimit sa më efikas të resurseve natyrore, vlerave të natyrës si dhe menaxhimit të mjedisit në Kosovë, Ministria krijon, organizon dhe mbanë Sistemin Informativ Mjedisor (në tekstin e mëtutjeshëm: SIM).

2. SIM bënë mbledhjen, klasifikimin, mirëmbajtjen, prezantimin dhe shpërndarjen e të dhënave numerike, përshkruese dhe hapësinore për:

- 2.1. cilësinë e medimeve të mjedisit;
  - 2.2. përcjelljen e gjendjes së mjedisit;
  - 2.3. masat ligjore, administrative, organizative dhe strategjike;
  - 2.4. informatat shkencore-teknologjike për masat e planifikuara për parandalimin e ndotjes;
  - 2.5. shkëmbimin e informatave me sistemet tjera informative etj.
3. SIM mundëson qasje në informata sistemeve tjera informative dhe harmonizon të gjitha informatat relevante në nivel të Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar.
4. Ministria me akt nënligjor, përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së SIM, metodologjinë, strukturën, bazat e përbashkëta, kategoritë dhe nivelin e grumbullimit të të dhënave, si dhe përmbajtjen e informacionit me të cilën informohet publiku rregullisht dhe detyrimisht.

### **Neni 53** **Kadastrit i ndotësve**

1. Për përcjelljen e ndryshimeve cilësore dhe sasiore në mjedis dhe për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit, mbahet kadastrit i ndotësve për shkarkimet në mjedis, për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve në mjedis, për ujën e përdorur, të energjisë dhe resurseve natyrore, në përputhje me këtë ligj.
2. Të dhënat nga kadastrit i ndotësve paraqiten në formën që siguron identifikimin e emisioneve dhe cilësive të mjedisit në mjedis, për çdo instalim e ndotës, vendndodhjen dhe shkarkimin e tyre në ajër, ujë e tokë.
3. Kadastrit i ndotësve hartohet në mbështetje të raportimit të rregullt nga personat juridik ose fizik, nga organet e autorizuar për grumbullimin dhe krijimin e të dhënave për mjedisin.
4. Kadastrit i ndotësve administrohet nga Ministria dhe është i hapur për publikun.
5. Ndotësi është i detyruar që me shpenzime të veta t'ia dorëzoj Ministrisë të dhënat e parapara në mënyrën dhe afatin e përcaktuar me ligj.
6. Formën, përmbajtjen, afatet dhe mënyrën e plotësimit, organin që e administron dhe rregullat e përdorimit të Kadastrit të ndotësve Ministri e përcakton me akt nënligjor

## **KREU VI INFORMIMI DHE PJESMARRJA E PUBLIKUT**

### **Neni 54 Qasja në informata**

1. Ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuarra dhe të tjera, janë të detyruara që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, respektivisht për dukuritë të cilat janë duke u përcjellë në kuadër të monitorimit të emisionit dhe cilësisë të mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin , shëndetin dhe jetën e njeriut, në përputhje me ligj.
2. Publiku ka të drejtë për qasje në regjistra ose evidenca që përmbajnë informata dhe të dhëna në përputhje me ligjin.

### **Neni 55 Dhënia e informacioneve sipas kërkesës**

1. Institucioni gjegjës, informacionet për mbrojtjen e mjedisit, sipas kërkesës, i ofron paraqitësit të kërkesës brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të kërkesës.
2. Nëse informatat nga paragrafi 1. i këtij neni janë voluminoze dhe për përgatitjen e tyre duhet shumë kohë, atëherë afati për dhënien e informatave shtyhet për gjashtëdhjetë ditë nga dita e pranimi të kërkesës.
3. Shpenzimet për informatat e ofruara nga paragrafi 1. të këtij neni, i bartë parashtuesi i kërkesës.
4. Ministri me akt nënligjor përcakton rregullat dhe procedurat për bërjen publike, shumën e shpenzimeve për shërbimin nga paragrafi 3. të këtij neni, varësisht nga vëllimi dhe natyra e informatës.

### **Neni 56 Refuzimi i kërkesës për dhënien e informatave**

1. Kërkesa për dhënien e informacioneve të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit mund të refuzohet nëse publikimi i këtyre informatave mund të ndikon në:
  - 1.1. besueshmërinë e punës së institucioneve qendrore dhe lokale kur është paraparë me ligj;
  - 1.2. raportet ndërkombëtare, mbrojtjen e vendit dhe sigurimin publik;

1.3. punën e organeve gjyqësore;

1.4. besueshmërinë e të dhënave komerciale dhe industriale kur të dhënat e tilla janë paraparë të mbrohen me ligj, përveç informatave për emisionin i cili e rrezikon mjedisin;

1.5. të drejtat e pronësisë intelektuale;

1.6. besueshmërinë e të dhënave personale, respektivisht dosjeve kur ato janë paraparë që të mbrohen me ligj;

1.7. interesat e palëve të treta të cilat posedojnë informacione, që nuk janë të detyruar t'i ofrojnë, respektivisht nuk pajtohen që ato të publikohen.

### **Neni 57**

#### **Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje**

1. Organet vendimmarrëse sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për:

1.1. vlerësimin strategjik mjedisor;

1.2. vlerësimin e ndikimit në mjedis;

1.3. procedurën e lëshimit të lejes ujore dhe lejes integruese;

1.4. nxjerrjen e ligjeve.

2. Publiku informohet përmes mjeteve të informimit për procedurën e marrjes së vendimeve dhe merr pjesë në dhënien e mendimit, komenteve dhe sugjerimeve institucionit kompetent dhe me kohë informohet për vendimin e marrë në pajtim me ligj.

### **Neni 58**

#### **Kufizimi i pjesëmarrjes së publikut në marrjen e vendimit**

Qeveria me qëllim të ruajtjes së interesit të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, mund të kufizojë pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimit, nga neni 57 të këtij ligji.

## **KREU VII ORGANIZATAT PËR MONITORIMIN E MJEDISIT**

### **Neni 59 Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës**

1. Me qëllim të monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit , Ministria themelon Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: AMMK).
2. Struktura organizative dhe përgjegjësitë tjera të AMMK përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 60 Detyrat e AMMK**

1. Detyrat e AMMK janë :

- 1.1. të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.2. të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë të dhënat për mjedisin;
- 1.3. ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- 1.4. të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- 1.5. të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit.
- 1.6. të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- 1.7. të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojlojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
- 1.8. të hartojë raporte për çështjet e caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngjashëm;
- 1.9. kryen punë këshillëdhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;

1.10. të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;

1.11. të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit - AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim – RREIV;

1.12. të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit ;

1.13. të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve të AEM.

1.14. shfrytëzimi dhe këmbimi ndërshtetëror i të dhënave për mjedis do të rregullohet me ligj të veçantë.

2. AMMK kryen edhe punë të tjera të përcaktuara në aktin për themelimin që shërbejnë për realizimin e veprimtarisë së AMMK të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 61**

#### **Organizatata tjera të autorizuara**

1. Përcjelljen e gjendjes së mjedisit mund ta kryejnë edhe organizatat tjera hulumtuese, shkencore dhe publike të autorizuara, nëse i plotësojnë kushtet në aspektin e kuadrove, pajisjeve, hapësirës, akreditimit, konform standardeve dhe parametrave të caktuara.

2. Ministria është kompetente për dhënien e autorizimit organizatave të tilla. Autorizimet epen pas marrjes së pëlqimit nga ministrit tjera gjegjëse në kuadër të të cilave veprojnë organizatat hulumtuese shkencore e publike.

3. Ministria nxjerr akt nënligjor për kushtet dhe kriteret tjera për dhënien e autorizimit organizatave nga paragrafi 1 i këtij neni.

### **Neni 62**

#### **Bordi Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit**

1. Kuvendi i Kosovës emëron Bordin Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit (në tekstin e mëtutjeshëm: Bordi) për të këshilluar Kuvendin dhe Qeverinë për çështje të mbrojtjes së mjedisit.

2. Bordi përbehet nga shtat (7) anëtar të cilët i emëron Kuvendi. Anëtarët e Bordit zgjidhen nga ekspertë dhe shkencëtar të dalluar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Anëtarët e Bordit nuk mund të jenë të punësuar në Ministri.



3. Bordi është i pavarur nga çdo autoritet tjetër.
4. Bordi jep mendime dhe sugjerime Kuvendit dhe Qeverisë për:
  - 4.1. gjendjen e mjedisit dhe trendet në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
  - 4.2. strategjinë dhe politiken për mbrojtjen e mjedisit dhe koordinimin e tyre me trendet ndërkombëtare;
  - 4.3. harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit;
  - 4.4. ligjet që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit;
  - 4.5. veprimtarinë e ministrive dhe aktivitetet e komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
  - 4.6. iniciativat publike;
  - 4.7. detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Neni 63** **Vetmonitorimi nga ndotësit**

1. Personi juridik dhe fizik, përkatësisht operatorët, që paraqesin burim të emisionit dhe të ndotjes së mjedisit, janë të detyruar që në përputhje me ligj, përmes institucioneve të caktuara, dhe organizatave të autorizuara të:
  - 1.1. kryejë monitorimin e emisionit dhe cilësisë së mjedisit;
  - 1.2. përcjellë edhe ndikimet e tjera nga aktivitetet e tij, në mjedis.
2. Ndotësi me mjete vetanake kryen, monitorimin e emisionit dhe cilësisë së mjedisit dhe përcjelljen e ndikimit të aktiviteteve të veta në mjedis.

### **Neni 64** **Dorëzimi i të dhënave**

Ministritë tjera, komunat, organizatat, organizatat e autorizuara dhe ndotësit janë të detyruar që të dhënat e monitorimit nga neni 50 dhe 63 të këtij ligji t'ia dorëzojnë Ministrisë sipas formës së përcaktuar me akt nënligjor.

## **KREU VIII DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSIA PËR NDOTJEN E MJEDISIT**

### **Neni 65**

#### **Detyrimet e personave juridik dhe fizik**

1. Personat juridik dhe fizikë janë të detyruar që gjatë të gjitha fazave të kryerjes së aktiviteteve të tyre të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit përmes:

- 1.1. zbatimit të dispozitave për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.2. shfrytëzimit racional të resurseve natyrore dhe të energjisë;
- 1.3. aplikimit të teknologjive të pastra;
- 1.4. shfrytëzimit të resurseve natyrore të përtritshme;
- 1.5. përdorimit të prodhimeve, proceseve, teknologjive dhe praktikave të cilat e rrezikojnë më pak mjedisin;
- 1.6. ndërmarrjes së masave parandaluese ose mënjanimit të pasojave të rrezikimit dhe dëmtimit të mjedisit;
- 1.7. mbajtjes së evidencës sipas procedurës së përcaktuar me ligj;
- 1.8. kontrollit të aktiviteteve dhe punës së pajisjeve të cilat mund të paraqesin rrezik ose mund të shkaktojnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- 1.9. përdorimit të metodave për analizën e ciklit jetësorë të prodhimeve;
- 1.10. marrjes së masave tjera në përputhje me ligj.

2. Masat për mbrojtjen e mjedisit nga paragrafi 1. i këtij ligji, personat juridik dhe fizikë i kryejnë në mënyrë të pavarur ose përmes organizatës së autorizuar.

### **Neni 66**

#### **Përgjegjësia për ndotjen e mjedisit**

1. Ndotësi i cili shkakton ndotjen e mjedisit, përgjigjet për dëmin e shkaktuar dhe bartë shpenzimet për vlerësimin dhe eliminimin e dëmit.

2. Për ndotjen e mjedisit, është përgjegjës personi juridik ose fizik i cili në mënyrë të paligjshme ose përmes veprimit të gabuar ka shkaktuar ose ka lejuar ndotjen e mjedisit.

**Neni 67**  
**Përgjegjësit nga përgjegjësia**

1. Nëse ndotësi dëshmon se ka aplikuar masat adekuate për mbrojtjen e mjedisit, të cilat i kanë diktuar rrethanat për të parandaluar ose zvogëluar dëmin, atëherë ndotësi mund të përjashtohet nga përgjegjësia për ndotje në këto raste:

- 1.1. kur dëmin e ka shkaktuar personi i tretë;
- 1.2. kur dëmi është shkaktuar nga fuqia madhore;
- 1.3. kur dëmi është shkaktuar si pasojë e konfliktit të armatosur.

**Neni 68**  
**Detyrimet e ndotësit të mjedisit**

1. Ndotësi i cili me veprimin ose mosveprimin e vet shkakton ndotjen e mjedisit, është i detyruar që të ndërmerret masat e parapara me planin e mbrojtjes nga aksidenti mjedisor, planin për sanim dhe planin për rehabilitim.

2. Nëse dëmi i shkaktuar në mjedis nuk mund të sanohet përmes masave adekuate, personi juridik ose fizik i cili ka shkaktuar dëmin, duhet ta kompensojë dëmin në vlerën e të mirave të shkatërruara.

**Neni 69**  
**Përgjegjësia për dëmin mjedisor**

1. Ndotësi është përgjegjës për dëmin mjedisor të shkaktuar në mjedis dhe ai duhet t'i bartë shpenzimet për vlerësimin e dëmit dhe mënjanimin e tij posaçërisht:

- 1.1. shpenzimet e intervenimit urgjent të ndërmarrë në momentin e shkakimit të dëmit, të cilat janë të domosdoshme për kufizimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- 1.2. shpenzimet e sanimit, krijimit të gjendjes së re ose rikthimin në gjendjen e mëparshme të mjedisit, si dhe monitorimin e efekteve të sanimit dhe efekteve të dëmit të shkaktuar në mjedis;
- 1.3. shpenzimet e kompensimit të personave juridik ose fizik të cilët janë të kërcënuar dhe të dëmtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes dëmtimit të mjedisit.

2. Ndotësi është i detyruar që të ofrojë garanci financiare ose ndonjë lloj tjetër të garancie për të siguruar kompensimin e shpenzimeve nga paragrafi 1. të këtij neni, gjatë dhe pas kryerjes së aktiviteteve.

3. Qeveria me akt nënligjor përcakton llojin e garancisë nga paragrafi 2. i këtij neni, shumën e mjeteve dhe kohëzgjatjen e garancisë të cilin duhet ta sigurojë ndotësi.

### **Neni 70**

#### **Detyrimet e sigurimit**

Çdo person juridik ose fizik i cili me veprimtari ose me aktivitetin e vetë paraqet nivel të lartë të rrezikut për mjedisin dhe shëndetin e njeriut duhet të sigurohet nga përgjegjësia në rast të dëmeve të shkaktuara palës së tretë.

### **Neni 71**

#### **Kompensimi i dëmit**

1. Secili që pëson dëm mjedisor ka të drejtë në kompensim.
2. Kërkesa për kompensimin e dëmit mund ti parashtrohet drejtpërdrejt ndotësit ose siguruesit të tij, respektivisht garantuesit financiar të ndotësit tek i cili ka ndodh aksidenti, nëse një sigurues, respektivisht garantues financiar i tillë ekziston.
3. Nëse më shumë ndotës janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar në mjedis, dhe nuk mund të përcaktohet saktësisht përgjegjësia e secilit ndotës, ata i bartin shpenzimet në mënyrë solidare dhe veç e veç.
4. Procedura për iniciimin e kompensimit të dëmit parashkruhet pas tre vjet prej momentit kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin e bërë dhe për dëmtuesin. Për çdo rast, kërkesa për kompensim parashkruhet pas tridhjetë vjet nga dita kur është shkaktuar dëmi.

### **Neni 72**

Për përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në mjedis te cilat nuk janë rregulluar në mënyrë të veçantë me këtë ligj, vlejné parimet e përgjithshme të Ligjit për detyrimet.

## **KREU IX**

### **FINANCIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

### **Neni 73**

1. Qeveria, respektivisht komunat në kuadër të drejtave dhe detyrimeve të tyre, sigurojnë financimin dhe realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

2. Qeveria me akt nënligjor i përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për aplikimin e instrumenteve ekonomike.

#### **Neni 74**

#### **Kompensimi për shfrytëzimin e resurseve natyrore**

1. Shfrytëzuesi i resurseve natyrore paguan për shfrytëzimin e tyre dhe i bartë shpenzimet për sanimin, rehabilitimin dhe rikultivimin e sipërfaqes së degraduar, në përputhje me aktet nënligjore.

2. Mjetet e realizuara nga paragrafi 1. i këtij neni, arkëtohen në Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ato shfrytëzohen në mënyrën e përcaktuar me akt të veçantë.

#### **Neni 75**

#### **Kompensimi për ndotjen e mjedisit**

1. Ndotësi është i detyruar që të paguajë kompensimin për ndotjen e mjedisit.

2. Kriteret, për përcaktimin e kompensimit nga paragrafi 1. të këtij neni janë:

2.1. lloji, sasia dhe vetitë e emisionit nga burimet e caktuara;

2.2. lloji, sasia dhe vetitë e emisionit të mbeturinave të prodhuara ose të deponuara;

2.3. përmbajtja e materieve të dëmshme në përbërje të lëndës së parë, gjysmë prodhim dhe prodhim.

3. Qeveria, me akt nënligjor, përcakton llojet e ndotjeve, kriteret për llogaritjen e kompensimit, detyruesin, lartësinë, mënyrën e llogaritjes dhe pagesën e kompensimit.

4. Mjetet të realizuara nga paragrafi 1. të këtij neni, shfrytëzohen për zbatimin e politikave të mbrojtjes dhe përparimit të mjedisit sipas programeve, respektivisht sipas:

4.1. strategjisë për mbrojtjen e mjedisit;

4.2. planeve të veprimit në mjedis;

4.3. planeve për sanimin;

4.4. planeve për rehabilitim;

4.5. planeve për rikultivimin e sipërfaqes së degraduar në përputhje me ligjin.

**Neni 76**  
**Kompensimet që i cakton komuna**

1. Në raste të jashtëzakonshme, komuna e cila e ka statusin e zonës së rrezikuar mjedisore përcakton kompensimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.
2. Qeveria me vendim e miraton ose refuzon kërkesën e komunës për caktimin e lartësisë për kompensimin nga paragrafi 1 i këtij neni, mënyrën e pagesës, si dhe lehtësimet për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.

**Neni 77**  
**Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit**

1. Për sigurimin e mjeteve financiare për stimulimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit në Kosovë, themelohet Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit.
2. Kompetencat, administrimi, burimet e financimit dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit, rregullohet me ligj të veçantë.

**Neni 78**  
**Shfrytëzimi i mjeteve**

Mjetet e ndara nga buxheti i Kosovës dhe institucionet financiare ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzohen përmes Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit

**Neni 79**  
**Masat e stimulimit ekonomik**

1. Personat juridik ose fizik që aplikojnë teknologjitë e pastra, vejnë në qarkullim prodhime dhe mallra, ndikimi i të cilave është më i favorshëm sesa i mallrave tjera të ngjashme, ose shfrytëzojnë burimet e përsëritshme të energjisë (ujin, diellin, erën, biogazin etj), instalimet dhe pajisjet të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbejnë për mbrojtjen e mjedisit, mund t'u caktohen lehtësime tatimore, doganore dhe lehtësime të tjera ose të lirohen nga detyrimi.
2. Për konsumatorët të cilët në mënyrë të organizuar i kthejnë pajisjet e shfrytëzuara dhe të papërdorshme ose pjesët e tyre, prodhimet ose ambalazhin e tyre, dhe për prodhuesit të cilët e sigurojnë riciklimin dhe largimin e tyre, respektivisht e zvogëlojnë ndikimin negativ të aktiviteteve të tyre në mjedis, mund të përcaktohen masa të posaçme të stimulimit si subvencione, depozitë dhe refundim.
3. Kushtet dhe mënyrat e stimulimit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni në propozim të Ministrisë, Qeveria e përcakton me akt nënligjor.

## **KREU X MBIKËQYRJA**

### **Neni 80 Mbikëqyrja administrative**

Mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj, e bënë Ministri.

### **Neni 81 Mbikëqyrja inspektuese**

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati mjedisor i Ministrisë.
2. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen inspektori komunal i mjedisit.
3. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera.
4. Punët e inspektorit mund t'i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna.

### **Neni 82**

1. Gjatë inspektimit të veprimtarive dhe aktiviteteve të personave juridik ose fizik, inspektori kërkon nga personi përgjegjës që:
  - 1.1. t'i mundësoj kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në të gjitha lokalet e punës, stabilimentet dhe pajisjet dhe në ambientet e hapura të personit të mbikëqyrur;
  - 1.2. të ofrojë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për mbikëqyrje inspektuese;
  - 1.3. të informoj për masat e ndërmarra lidhur me eliminimin e të metave të konstatuara.
2. Personat juridik ose fizik, veprimtaritë dhe aktivitetet e të cilëve i nënshtrohen mbikëqyrjes, janë të detyruar që inspektorit t'i mundësojnë zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, ti ofrojnë dokumentacionin dhe të gjitha të dhënat e nevojshme.

### **Neni 83**

1. Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për mbrojtjen e mjedisit kryen mbikëqyrjen sidomos për:

- 1.1. zbatimin e standardeve të kualitetit për pjesët përbërëse të mjedisit;
- 1.2. zbatimin e standardeve teknike për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.3. zbatimin e monitorimit të gjendjes së mjedisit;
- 1.4. zbatimin e matjes së emisionit dhe imisionit dhe mbajtjen e evidencës për to;
- 1.5. zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me programin për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.6. zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me planin për intervenim;
- 1.7. zbatimin e kushteve të përcaktuara në pëlqime, autorizime dhe leje të lëshuara në bazë të ligjit;
- 1.8. zbatimin e planeve për sanim, rehabilitim dhe intervenim si dhe përcjelljen dhe realizimin e tyre;
- 1.9. mënyrën dhe kushtet e punës, përgatitjen teknike të personave të regjistruar ose të autorizuar për kryerjen e punëve për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.10. mënyrën e udhëheqjes të kadastrit të ndotësve dhe evidencës për mjedis;
- 1.11. shfrytëzimin e mjeteve të destinuara për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.12. zbatimin e akteve ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- 1.13. kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Neni 84**

Inspektori është i detyruar të hartoj raport mbi kryerjen e mbikëqyrjes, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet e ndërmarra, gjegjësisht të urdhëruara. Një kopje të raportit ia dorëzon personit të i cili është bërë mbikëqyrja inspektuese.



## Neni 85

1. Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori me vendim me shkrim mund të urdhëroj personin juridik ose fizik qe:

1.1. në afat të caktuar të mënjanoj të metat dhe parregullsitë në veprimtaritë dhe aktivitetet, për shkak të cilave ka ardhur ose mund të vijë deri te ndotja e mjedisit;

1.2. të ndalojë përkohësisht kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit në procesin e prodhimit, shfrytëzimin e stabilimenteve, mjeteve dhe pajisjeve nga të cilat ka ardhur ose mund të vijë deri tek ndotja e konsiderueshme e mjedisit;

1.3. të ndalojë kryerjen e aktivitetit në procesin e prodhimit, përdorimin e stabilimenteve , mjeteve dhe pajisjeve nga të cilat ka ardhur ose mund të vij deri te një ndotje më e madhe e mjedisit, derisa të metat dhe parregullsitë në punë të mos eliminohen;

1.4. të ndalojë punimet nëse ato kryhen në kundërshtim me masat e përcaktuara për vlerësimin e ndikimit në mjedis deri sa parregullsitë të mënjanohen;

1.5. të ndërpres punimet nëse ato nuk kryhen në pajtueshmëri me kushtet e dhëna;

1.6. të ndaloj punët për të cilat ai nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë profesionale për mbrojtjen e mjedisit.

2. Nëse personi juridik ose fizik nuk zbaton masat nga nën-paragrafi 1.1 paragrafi 1. i këtij neni, inspektori në afat të arsyeshëm të ndërmerr masa përmes personave të tjerë në shpenzime të shkaktuesit të dëmit.

3. Për faktet e verifikuara në procedurën e inspektimit, gjegjësisht për masat e ndërmarra, inspektori është i detyruar ta njoftojë personin e paditur.

4. Me qëllim të sigurimit të zbatimit të ndalesave dhe shkeljeve të përcaktuara me dispozita të tjera, inspektori për mbrojtjen e mjedisit ka të drejtë dhe obligim qe:

4.1. pa vonesë të parashtrrojë fletëparaqitje organit kompetent për veprën e dënueshme;

4.2. t'i propozoj organit kompetent fshirjen nga regjistri i veprimtarisë për të cilën vërtetohet se personi nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj;

4.3. të ndërmerr masa të tjera për të cilat është i autorizuar.

**Neni 86**  
**Detyrimet e inspektorëve për bashkëveprim**

Në rastet kur inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese vlerëson se përveç shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij , janë shkelur edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, është i detyruar që krahas marrjes së masave për të cilat është i autorizuar, të njoftoj edhe organin tjetër kompetent në mënyrë që bashkërisht të kryejnë mbikëqyrjen inspektuese dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj.

**Neni 87**  
**Procedurat e ankesës**

1. Inspektori, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, nxjerr vendim.
2. Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal vendos Ministria.
3. Në ankesa kundër vendimit të inspektorit mjedisor në nivel qendror vendos Ministria.
4. Kundër vendimit të Ministrisë, mund të iniciohet kontest administrativ pran gjykatës kompetente.
5. Për rastet e eliminimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për mjedisin, jetën dhe shëndetin e njeriut ankesa e ushtruar kundër vendimit të inspektorit, nuk e shtynë ekzekutimin.

**Neni 88**

1. Për të parandaluar paraqitjen e dëmit të paevitueshëm për mjedisin, përkatësisht ndërmarrjen e masave urgjente ose mënjanimin e rrezikut për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, inspektori gjatë mbikqyrjes mund të merr vendim me gojë.
2. Inspektori mundë të shqiptojë vendim me gojë në rastet kur është e nevojshme të shmangët rreziku i drejtpërdrejt për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe llojllojshmërisë biologjike.
3. Vendimi me gojë shkruhet në procesverbal me shenjën se vendimi në formë të shkruar duhet ti dërgohet palës në afat prej tetë ditë.

**Neni 89**

1. Inspektori mbanë procesverbalin për inspektimet e kryera.
2. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së procesverbalit nga paragrafi 1. i këtij neni e përcakton Ministria.

3. Inspektorati mjedisor e përgatitë raportin vjetor mbi punën e vet të cilin ia paraqet Ministrisë me propozimin për ndërmarrjen e masave për përmirësimin gjendjes së mjedisit.

#### **Neni 90**

1. Inspektorët legjitimohen përmes kartës së identitetit.
2. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e lëshuarjes të kartës së identitetit, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

#### **Neni 91**

Punët e inspektorit mund t'i kryej personi i cili e ka përgatitjen superiore profesionale dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

### **KREU XI DISPOZITAT NDESHKUESE**

#### **Neni 92**

Kur shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, Inspektorati i Mjedisit përmes Ministrisë ia dorëzon lëndën prokurorisë.

#### **Neni 93 Kundërvajtjet**

1. Me gjobë në të holla prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik nëse:

1.1. shfrytëzon resurset natyrore pa pëlqimin mjedisor të Ministrisë (neni 10 paragrafi 2. të këtij ligji);

1.2. gjatë shfrytëzimit të resurseve natyrore, kryerjes së punëve, si dhe pas përfundimit të tyre nuk i zbaton masat e parapara për parandalimin e rrezikimit të mjedisit (neni 11 paragrafi 1 të këtij ligji);

1.3. nuk bënë sanimin dhe rekultivimin ose nëse në ndonjë mënyrë tjetër nuk bënë rehabilitimin e mjedisit të degraduar (neni 11 paragrafi 2 të këtij ligji);

1.4. zhvillon aktivitete në natyrë të cilat degradojnë veçoritë e vlerave natyrore (neni 12 paragrafi 2 të këtij ligji);

1.5. gjatë administrimit me materie të rrezikshme nuk ndërmerr të gjitha masat e duhura mbrojtëse dhe të sigurisë (neni 16 paragrafi 2 të këtij ligji);

1.6. në rast të tejkalimit të normave të lejuara të emisionit, cilësisë të mjedisit dhe aktiviteteve tjera nuk realizon planin sanues (neni 23 paragrafi 3 të këtij ligji);

1.7. nuk e kthen pjesën e dëmtuar të mjedisit në gjendjen që nuk paraqet rrezik (neni 34 paragrafi 1 të këtij ligji);

1.8. nuk i paraqet Ministrisë planin për masat që duhet të ndërmerren (neni 34 paragrafi 3 të këtij ligji);

1.9. importon dhe eksporton substanca të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit (neni 45 paragrafi 2 të këtij ligji);

1.10. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 47 të këtij ligji;

1.11. nuk ndërmerr masa të sanimit sipas planit për mbrojtje në rast të aksidentit mjedisor (neni 49 paragrafi 1 të këtij ligji);

1.12. nuk bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 50 paragrafi 2 të këtij ligji);

1.13. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 51 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji;

1.14. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 63 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.15. nuk ndërmerr masat e parapara me planin për mbrojtjen nga aksidenti mjedisor (neni 68 paragrafi 1 të këtij ligji);

1.16. nuk i bartë shpenzimet për vlerësimin e dëmit dhe mënjanimin e tij (neni 69 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji);

1.17. nuk sigurohet nga përgjegjësitë në rast të dëmeve të shkaktuara palës së tretë (neni 70 të këtij ligji);

1.18. nuk paguan kompensimin për ndotjen e mjedisit (neni 75 paragrafi 1 të këtij ligji).

2. Me gjobë në të holla në lartësi prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro gjobitet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personi përgjegjës i personit juridik.

## **Neni 94**

1. Me gjobë në të holla në lartësi prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro për kundërvajtje personi juridik nëse:

- 1.1. nuk e siguron lejen e integruar mjedisore (neni 30 paragrafi 1 të këtij ligji);
- 1.2. prodhon substanca të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit (neni 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji);
- 1.3. importon dhe eksporton substanca, prodhimet dhe pajisjet, të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit, respektivisht prodhimet të cilat përmbajnë këto substanca, të cilat janë në listën e Protokollit të Montrealit (neni 45 paragrafi 2 i këtij ligji);
- 1.4. shfrytëzon shenjen EMAS sistemet e certifikuara të menaxhimit të mjedisit ISO 9000, ISO14001 pa qen i regjistruar sipas ligjit (neni 42 të këtij ligji);
- 1.5. përdor etiketën mjedisore në kundërshtim me dispozitat e nenit 43. të këtij ligji.
- 1.6. nuk i dorëzon Ministrisë të dhënat sipas dispozitave të nenit 53 paragrafi 6 i këtij ligji.;
- 1.7. kryen monitorimin e mjedisit pa autorizim nga Ministria (neni 61 paragrafët 1. dhe 3. të këtij ligji.);
- 1.8. nuk mundëson zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, nuk ofron informata dhe të dhënat tjera të nevojshme (neni 88 paragrafi nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij ligji);
- 1.9. në afatin e caktuar nga inspektori nuk ndërmerret masat e duhura lidhur me mënjanimin e të metave të konstatuara (neni 82 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të këtij ligji).

2. Me gjobë në të holla në lartësi prej treqind (300) deri njëmijë (1.000) Euro gjobitet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i personit juridik.

3. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni gjobitet edhe personi fizik.

## **Neni 95**

1. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro për kundërvajtje gjobitet personi përgjegjës i organit shtetëror nëse:

- 1.1. lëshon leje për përdorimin e resurseve natyrore pa pëlqimin e Ministrisë (neni 10 paragrafi 2);

1.2. nxjerr planin hapësinor dhe urbanistik ne kundërshtim me dispozitat e nenit 27 te këtij ligji;

1.3. bën regjistrimin e personit juridik e fizik ne sistemin EMAS ne kundërshtim me dispozitat e nenit 42 te këtij ligji;

1.4. nuk e informon publikun në rast te rrezikut te drejtpërdrejt ose ne rast te tejkalimit normave te lejuara te ndotjes se mjedisit sipas dispozitave te nenit 38 te këtij ligji.

## **KREU XII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 96**

Qeveria dhe Ministria në afat prej dy vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet t'i nxjerrin aktet nënligjore për të cilat janë të autorizuar me këtë ligj.

### **Neni 97**

Personat juridik dhe fizik janë të obliguar të harmonizojnë veprimtarinë e tyre në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 98**

Dispozitat ligjore me të cilat rregullohen menaxhimi i resurseve natyrore, si dhe planifikimi dhe ndërtimi, e të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj, nuk aplikohen.

### **Neni 99**

Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga neni 96 dhe 97 të këtij ligji, aplikohen dispozitat në fuqi nëse ato nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 100**

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Rregullorja 2003 /9) dhe Udhëzimi Administrativ (nr. 2/2004) për themelimin e Inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit.

**Neni 101**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-025**  
**26 shkurt 2009**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**